



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 13 korrik 2016, merr këtë

V E N D I M

I.

1. Komuna e Prishtinës merr vendim që të subvencionojë prindërit të cilët kanë regjistruar fëmijët e tyre në çerdhen me bazë në komunitet "Botanika".
2. Subvencionimi i prindërve do të bëhet në bazë të të ardhurave mujore si në vijim:
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 Euro, me 50 Euro;
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, me 30 Euro; dhe
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, me 20 euro.
3. Ky vendim mbulon edhe subvencionimin e muajit qershor 2016.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër protokollit 01-422-179107 i marrë me datën 12 korrik 2016.

OBLIGOHEN Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Pronë dhe Financa ta zbatojnë këtë vendim.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Për shkak të pamundësisë financiare të shumë prindërve për të përballuar koston e çerdheve publike dhe atyre me bazë në komunitet, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

I DORËZOHET:

- Drejtorisë së Arsimit;
- Drejtorisë për Financa dhe Pronë; dhe
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eë.prishtina-komuna.org>

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

